



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	22.03	2022	viti god year
Organ/Rjesja Organ/Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/HRK	1492/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.145/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.145/2022 të datës 18.02.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër KVLBK Nr.01/2022 të datës 18.01.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.145/2022 e datës 18.02.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KVLBK Nr.01/2022 i datës 18.01.2022, të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes.

A r s y e t i m

Ministria e Mbrojtjes sipas Njoftimit të datës 08.11.2021 ka shpallur konkursin e brendshëm me nr.ref.RPC0001632 për "Lëvizje brenda kategorisë së mesme drejtuese në pozitën e lirë "Drejtor i Departamentit Ligjor" me datë 23.11.2021.

Ankuesja, [redacted] sipas shkresave të lëndës ka aplikuar në konkursin e shpallur te datës 23.11.2021 dhe e njëjta i ka plotësuar kushtet ligjore për të marrë pjesë në intervistë me gojë sipas procedurës për lëvizje brenda kategorisë së mesme drejtuese. Ankuesja me datë 29.12.2021 është njoftuar se nga intervista me gojë e mbajtur me datë 24.12.2021 është renditur e dyta në listë me gjithsej 75.4 pikë.

Ankuesja e pa kënaqur me njoftimin e datës 29.12.2021 për kandidatin fitues me datë 11.01.2021 ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes.

Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes me datë 18.01.2022 ka nxjerrë Vendim me numër KVLBK Nr.01/2022, me të cilin i është refuzuar ankesa si e jashtë afatshme (pasafatshme), duke lënë në fuqi Vendimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, për rezultatin e intervistimit për pozitën "Drejtor i Departamentit Ligjor" në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ankuesja [redacted] me datë 18.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër KVLBK Nr.01/2022 të datës 18.01.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen brenda Kategorisë në Shërbimin Civil, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale si dhe vlerësimit të gabuar, jo real dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 24.02.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mbrojtjes, ndërsa me datë 09.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Mbrojtjes, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot: 872/2022 të datës 18.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me KVLBK Nr.01/2022 e protokolluar me nr.69 të datës 18.01.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes; Ankesa e datës 11.01.2022 drejtuar Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes; E-mail i datës 10.01.2022 njoftim; E-mail i datës 29.12.2021, lidhur me njoftimin nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë për përfundimin e procesit të kandidatëve; E-mail i datës 07.12.2021 për verifikim të aplikacioneve; Shpallja e konkursit të datës 23.11.2021 sipas njoftimit të datës 18.11.2021 për lëvizje brenda kategorisë nga Ministria e Mbrojtjes; Vendimi i datës 06.01.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme për anulimin e procedurave të rekrutimit për pozitën e nivelit të lartë drejtues; Përgjigje në ankesë e datës 09.03.2022 e protokolluar me nr.1250/2022 me shkresat përcjellëse, Vendimi i datës 06.12.2021, për verifikimin paraprak të aplikacioneve për kandidatët, bashkëngjitur listën e aplikacioneve nga sistemi elektronike SIMBNJ; Vendimi nr. protokollit 2942 i datës 06.12.2021 për emërimin e komisionit për verifikimin kandidatëve për lëvizje brenda kategorisë; Vendimi nr. protokollit 3141 i datës 20.12.2021 për ndryshim dhe plotësim të Vendimit nr. prot.2942 të datës 06.12.2021; Vendimi nr. protokollit 2958 i datës 07.12.2021 për ndryshim dhe plotësim të Vendimit nr. prot.2942 të datës 06.12.2021, Aplikacioni i datës 29.11.2021

Aplikacioni i datës 30.11.2021 znj. Raport përfundimtar mbi rezultatin e vlerësimit të kandidatëve për pozitë "Drejtor i Departamentit Ligjor"; Njoftim i datës 29.12.2021 për kandidatin e fitues; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Njoftimi i datës 29.12.2021 E-mail; Ankese me E-mail i datës 11.01.2022; Njoftim për mes E-mailit për Vendimin nga komisioni për verifikim për lëvizje brenda kategorisë.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Sipas shkresave të lëndës është konstatuar se Ministria e Mbrojtjes sipas Njoftimit të datës 08.11.2021 ka shpallur konkursin e brendshëm me nr.ref.RPC0001632 për "Lëvizje brenda kategorisë së mesme drejtuese për pozitën e lirë "Drejtor i Departamentit Ligjor" me datë 23.11.2021. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se në konkursin e datës 23.11.2021 të shpallur Ministria e Mbrojtjes me rastin e shpalljes se konkursit, ka përcaktuar kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, si në vijim: *Të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.* Ndërsa sipas konkursit në fjalë si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Diplomë/a të Fakulteti juridik –jurist i diplomuar më të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; si dhe Përvoja e punës e kërkuar: Së paku shtatë (7) vite përvojë profesionale përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese.*

Në këtë konkurs kanë aplikuar dy (2) kandidatë, dhe të dy kandidatët janë vlerësuar se plotësojnë kriteret e konkursit dhe të njëjtit janë përfshirë në listën e ngushtë të datës 06.12.2021. Komisioni për Vlerësimi për Lëvizje Brenda Kategorisë i themeluar sipas Vendimit me numër protokoll 2942 /2021 të datës 06.12.2021, i cili vendim është ndryshuar me Vendimin me numër protokoll 3141 të datës 20.12.2021 , pas përfundimit të procedurës së intervistimit, me datë 24.12.2021 ka përgatitur listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, sipas të cilës kandidati Avdyllkadër Muçaj është listuar si kandidati me më shumë pikë, me gjithsejtë 88.8 pikë, ndërsa ankuesja është renditur si kandidatja e dyte me gjithsejtë 75.4 pikë. Bazuar në listën përfundimtare të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes, Divizioni për Burime Njerëzore pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me datë 29.12.2021 e ka njoftuar ankuesen individualisht lidhur me përfundimin e procesit të vlerësimit dhe rezultatin dhe renditjen e saj sipas vlerësimit. Po ashtu Divizioni për Burime Njerëzore pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me datë 29.12.2021 e ka publikuar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm, përmes të cilit, kandidati është rekomanduar për emërim në pozitën e punës "Drejtor i Departamentit Ligjor". Ankuesja, Minire Begaj Balaj e pakënaqur me listën përfundimtare të datës 29.12.2021, me datë 11.01.2022 ka parashtruar ankesë pranë Komisionin të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në faktet e lartcekura dhe dëshmitë të ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesja ka konstatuar se ankuesja me datë 29.12.2021 është njoftuar individualisht nga Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Mbrojtjes, lidhur me përfundimin e procesit të vlerësimit, rezultatin dhe renditjen e saj në listën përfundimtare sipas vlerësimit, ndërsa ankesën në Komisionin për Vlerësimin për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes kundër listës përfundimtare e ka parashtruar me datë 11.01.2022, jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 50 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku theksohet se: **"1.Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual"**.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KVLBK Nr.01/2022 të datës 18.01.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, sepse ankesa e ankueses e datës 11.01.2022 është jashtë afatit ligjor për parashtrim të ankesës kundër njoftimit të datës 29.12.2021 siç e përcakton neni 50 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, citoj :“ *Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual*” dhe “*2.Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj*”.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.145/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshme në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.